

## AGRON GJEKMARKAJ

ZHANRI I MEMUAREVE, EPISTOLAVE DHE BIOGRAFISË NË  
LETERSINË SHQIPTARE

Zanafillën e saj letërsia memuaristike e ka te *Shkrimet e shenjta* dhe më pas te kujtimet e Ksenofontit për Sokratin (në shekullin IV p. e. s.) dhe “Anabazisi” i tij (në vitin 401 p. e. s.) – shënime mbi fushatën luftarake të grekëve. Modelet antike të zhanrit, të cilit i përkasin gjithashtu edhe të dhënat mbi “Luftën e Galisë” të Jul Çezarit (në shekullin I p. e. s.), megjithëse të personalizuar, priren drejt kronikës historike. Mesjeta kristiane me “Rrëfimet” (rreth vitit 400 të e. s) e Shën Agustinit, “Historia e fatkeqësive të mia” (1132–1136) të Pjer Abelar, pjesërisht “Vita Nova” (1292) e Dantes dhe të tjera monumente, ndërkallin në këtë zhanër një ndjenjë intensive të “unit” të brendshëm të rrëfyesit, një vetëthellim moral analitik dhe tonalitete pendese.

Çlirimi i individualitetit në mesjetë dhe përparimi i vetëdijes individualiste në epokën e Rilindjes, të pasqyruara në jetën e Benvenuto Çelinit (1558–1565), parapërgatitën një lulëzim të memuaristikës në shekullin 17–18 (Sen-Simoni, kardinali Mazarin, Ruso etj). Pas shekullit të 18-të kjo letërsi përparon shumë, duke njohur një lulëzim të madh gjatë shekullit të 20-të. Botimi i kujtimeve të Silvio Pelikos “*Burgjet e mia*” në Milano, në vitin 1836-të, themelon traditën e memuaristikës moderne të persekutimit politik. Rilindasi ynë Pashko Vasa, i cili mori pjesë në luftën e vitit 1849 në mbrojtjen e Venedikut, u ndikua dukshëm nga Peliko, aq sa edhe te kujtimet e veta ruajti në formë një titull të ngjashëm “*La mia Prigionia-Burgu im*”, të cilin e botoi në Kostandinopojë në vitin 1850-të. Aq i madh do të ishte ndikimi i librit të Pelikos, sa që në shtypin e kohës thuhej se ai ishte për perandorinë Hasburge më i dëmshëm sesa një kryengritje. Me fillimin e shekullit të 20-të, kur përplasja ideologjike është shumë e fortë, fiton terren dëshmia me karakter politik e të burgosurve dhe e të internuarve të ndërgjegjes, duke kulmuar me “*Fletoret e burgut*” të Antonio Gramshit, “*Ditari i Ana Frankut*”, “*Kujtimet*” e Margarete Buber Neuman-it që përjetoi kampet e përqendrimit të nazizmit dhe të komunizmit, si dhe veprat e Primo Levit me karakter dëshmues etj. Leximi i këtyre dëshmimeve ka tronditur botën duke e ndërgjegjësuar atë për krimet e regjimeve totalitare.

Pas Luftës së Dytë Botërore bëhen të kërkuara rrëfimet e personazheve që kanë mbizotëruar në këtë periudhë si kujtimet e Çurçillit, të cilat nderohen me çmimin Nobel në Letërsi, të De Golit, si dhe të gjeneralit Zhukov. Por edhe ata që humbën, kanë qasjen e vet historike, e kam fjalën për gjeneralë të fashizmit si Graziani që shkroi një “*Autobiografi*” apo guvernatori i Rajhut për

Ballkanin Perëndimor, Nojerbah-i, i cili në kujtimet e veta flet gjerësisht edhe për Shqipërinë dhe për marrëdhëniet e tij me At Anton Harapin, Mehdi Frashërin e të tjera personalitete. Ditari i Galeazzo Çianos pas luftës do të bëhej bestseller. Në të zë një vend të rëndësishëm Shqipëria, ku një ndër kapitujt kryesorë është "Il Regno del Albania" (Mbretëria e Shqipërisë) nga ku aty gjejmë edhe përcaktimet e tij zemërike për françeskanët. Mëkëmbësi i mbretit Viktor Emanueli në Shqipëri gjatë pushtimit italian, Françesko Jakomoni di San Saviano, me kujtimet e tij për kohën e mëkëmbësisë në Shqipëri jep këndvështrimin e tij për ngjarjet dhe personazhet. Quaroni, një diplomat italian i karrierës në vitet '20-30, "*Valixhen diplomatike*" e ka të mbushur me kujtime nga Shqipëria dhe nga elita e saj politike. Ushtarët italianë me shërbim në Shqipëri u dërgojnë me mijëra letra familjarëve të tyre, me shumë të dhëna për banorët dhe vendin. Pranë nesh në Jugosllavi botohen kujtimet e Gjilasit dhe Kardelit, bashkëpunëtorë të Titos, të cilët ndonëse ishin përjashtuar nga nomenklatura drejtuese, lejohen të botojnë kujtimet e tyre, ku në to flitet edhe për marrëdhëniet me regjimin shqiptar në periudhën 1944-1948, duke portretizuar edhe disa prej politikanëve kryesorë të vendit tonë sipas optikës së tyre. Shumë shkrimtarë, disidentë e politikanë në Europën Lindore filluan të shkruajnë kujtimet e tyre pas rënies së Murit të Berlinit. Por shumë para ndryshimeve, Shollohovi dhe Solzhenicini botojnë në Perëndim dëshmitë e tyre tronditëse. Gama e memuaristikës në shekullin e 20-të është tepër e gjerë. "*Në këto memuare reflektohen etapat kthesë në zhvillimin mendor të personalitetit, kuptimit të "vetes në botë" dhe të "botës në vetvete"*",<sup>1</sup> - thotë Boris Tomashevski.

Sipas hulumtimeve të studiuesve letërsisë, një prej arsyeve që shpjegon "bumin" e shkrimit dhe të leximit të memuarëve është ndryshimi i historisë, përkundër parashtrimit të saj të ngurosur në tekstet zyrtare, apo, nëse shprehemi me gjuhën e shkencës së letërsisë, - ndryshimi i "subjektit të jetës" provokon interes për pasqyrimin e subjektivitetit mbi faktet objektive, të dhëna jashtë përjetimit psiko-antropologjik. Për përpjekjet e vetëshprehjes së subjektit nëpërmjet shkrimit është e domosdoshme kataklizma historike, qoftë kataklizma në kulturë (ndërrimi i religjioneve, ideologjive), qoftë përmbysjet historiko-politike (ndërrimi i pushteteve politike apo përmbysjet e dhunshme me revolucione). Nëse historia është bërë me duart e autorit, ai përpiqet të ruajë dhe të dëshmojë dokumentarisht atë çfarë ka ngjarë në shekuj. Kështu shfaqen memualet publicistike, të mbingarkuara me material faktik dokumentar mbi jetën e veprimtarëve politikë apo ushtarakë. Tek artistët ekziston një tjetër perceptim: ndjesia e estetizuar e realitetit e shtrëngon atë të perceptojë vetveten si një bartës i fatit të botës "në minutat e saj fatale", si një

<sup>1</sup> Boris Tomashevski, "*Letërsia dhe biografia*", "MM", f. 89, nr. 2-3, 2009.

borxh para lexuesve dhe vetvetes - të mbresojë KOHËN. Kësisoj, vihen re retrospektiva të caktuara të memuaristikës: individualo-subjektive dhe kronologjiko-estetike. Problem nistor bëhet korrelacioni ndërmjet konceptit të personalitetit, karakteristik për epokën, dhe paraqitjes së tij artistike. Madje nëse shqyrtojmë strukturën estetike të memuareve në mënyrë të vazhdueshme, studiuesi pashmangshëm dhe pavullnetshëm do të na "njohë" edhe me cilësinë historike. Sepse pikërisht "theksi mbi autenticitetin", sipas Ginsburg-ut, fakti i vërtetë historik është një prej treguesve që përcaktojnë natyrën zhanrore të memuaristikës. Së këndejmi, është e pamundur t'i shmangesh kontekstit historiko-kulturor në studimin e veprave të zhanrit memuaristik.

Për historinë dhe letërsinë shqipe, nëse e konsiderojmë gjithsesi tonën atë periudhë ku shqiptarët shkruan në latinisht, letërsia memuaristike i bie të zërë fill me botimin e veprës "*Rrethimi i Shkodrës*" të Marin Barletit në vitin 1504 në Venedik, në të cilën ai rrëfen historinë dramatike të qëndresës qytetërimore për jetë a vdekje që qyteti i Shkodrës i bën rrethimit osman. Ai rrëfen si pjesëmarrës në të, me cilësinë e dëshmitarit. "*Memoriet*" e Gjon Muzakës, të cilat shkruhen në kontekstin historik të një lufte të re antiturke në horizont me mundësi çlirimi për trojet arbërore, shpjegojnë gjeoneologjitë e gjakut përkundrejt pronave të familjes dhe atyre të lidhura më këtë fis, duke shënuar momentin e dytë të asaj letërsie memoristike që vërtitet rreth asaj kombëtare shqipe. Pashënia e "*Mesharit*" të Gjon Buzukut, dokumentit të parë të shqipes së shkruar, ka elemente të rrëfimitarisë dëshmuese: "Unë Gjoni, i biri i Bdek Buzukut...".

Letërsia memuaristike në kulturën shqiptare shfaqet qysh herët në disa zhanre. Nëse Barleti, Muzaka, Buzuku japin modelin klasik të dëshmisë nëpërmjet kujtimeve dhe shpjegimeve në vetë të parë, Budi me Bogdanin e realizojnë me epistolat letërkëmbimin dhe komentet e tyre. Kjo gjë vihet re te Budi me relacionet e tij të njohura me Kardinalin Gocadin në vitin 1621, ndërsa te Bogdani jo vetëm me mecenatin e tij, Kardinalin Françesko Barbarigo, por edhe me Papët dhe Propagandën Fide duke filluar që në vitin 1657-të e derisa vdiq. *Vepra e tij madhore "Cuneus prophetarum" – "Çeta e profetëve" paraprihet me rreth 50 faqe letra, kushtime, vlerësime e komente, që dëshmojnë lidhjet e autorit me kohën, me botën e letrave, me individë dhe institucione që prekin gjysmën e Europës së kohës*.<sup>2</sup> "*Për rëndësinë dhe qëllimin e këtyre letrave është folur gjatë në shumë botime, por do të theksonim se nga letërkëmbimi i Bogdanit, At Luigj Marlekaj ia del të konturojë jetën e Bogdanit dhe relievin shoqëror të Shqipërisë së asaj kohe me*

---

<sup>2</sup> Shaban Sinani, op. cit., f. 415-428.

veprën “Pjetër Bogdani dhe Shqipnia e kohës së tij.”<sup>3</sup> Gjithashtu, kodikët e ndryshëm që ne disponojmë kanë plot elemente dëshmuese dhe dokumentarë.

Me Rilindjen Kombëtare e pas saj kjo letërsi vjen e pasurohet më tej me vepra si “Burgu im” i Pashko Vasës, “Autobiografia” e Jeronim De Radës, “Kujtimet” e Ismail Qemalit, si dhe “Biografia” e Faik Konicës e shkruar në vetë të tretë. Proza e Fishtës si “Një udhëtim në Turki të re”, “Lot Gjaku” etj., kujtimet e Konicës për Nolin, Gjeçovin, Bajram Currin janë të mbushur me elemente të letërsisë memuaristike. Nga fillimi i Luftës së Dytë Botërore Vedat Kokona i sjell letërsisë sonë “Shënime udhëtimi Tiranë-Stokholm” dhe nga fundi i saj, shtypshkronja “Gutenberg” boton në gjermanisht një libër krejt të rrallë në letrat shqipe, diçka të ndërmjetme mes epistolarit dhe nekrologut, “Letra gruas sime të vdekur” të Egon Gjadrut, i cili ka mbetur pak i njohur. Me vendosjen e regjimit komunist, kujtimet e vetme të lejuara janë ato të diktatorit si “Titistët”, “Hrushovianët” apo “Kujtime vegjeli”, duke u pasuar nga Ramiz Alia me kujtimet dhe vlerësimet personale për diktatorin, të titulluara “Enveri ynë”.

Jashtë Shqipërisë kultivohet memuaristika e emigracionit. Në vitin 1960-të botohet në Amerikë “Autobiografia” e Fan Nolit. Eqerem bej Vlora shkruan herët kujtimet e tij në gjermanisht, por ato për lexuesin e gjerë shqiptar vijnë vetëm në vitet 2000. Po ashtu edhe “Kujtimet” e Mehdi Frashërit apo “Kujtime vogjlie e rinie” të Mustafa Krujës janë shkruar para shumë kohësh, por që janë botuar tash së voni.

Në epokën e lirisë në Shqipëri merr trajtë memuaristika që ishte ngjizur në burgjet e komunizmit, me dëshmi tronditëse për atë histori që nuk është shkruar kurrë. Ato janë kujtime pa pretendime të mirëfillta historike, por që mirëfilli mund t’i shërbejnë historisë. Jo të gjitha kanë lartësi stili, por mund të thuhet që të gjitha kanë autencitet. Nga veteranët e burgjeve të Komunizmit deri më sot njohim vepra të tilla si “Rrno vetëm për me tregue” i At Zef Pllumit, “Martirët” i Pjetër Arbnorit, “Rruga e ferrit” dhe “Ferri i çarë” i Visar Zhitit, “Burgjet e mia” i dom Simon Jubanit, “Cinarët” i At Konrad Gjolajt, “21 vjet burg komunist” i Uran Kalakulës, “Nga shkaba me dy krena te drapëri me çekan” i Beqir Ajazit, “Si u krijua Partia Social Demokrate?” i Musine Kokalarit, “Kokëqethja”, “Palltoja e burgut”, “Thesi i burgut” të Maks Velos, “Fundi i Siberisë shqiptare” i Leka Totos, “Ridënimi” i Fatos Lubonjës, “Nën peshën e dhunës” i Todi Lubonjës, “Libri i zi i komunizmit” i Agim Mustës, “Kujtimet e një europiani” i Jusuf Vrionit, “Larg dhe mes njerëzve” i Liri Lubonjës, “Një jetë në diktaturë - kujtime të një armiku të klasës” i Eugjen Merlikës dhe “Në gjurmët e një ditari” i Ahmet Bushatit. “Por në shumë raste

<sup>3</sup> At Luigj Marlekaj, “Pjetër Bogdani dhe Shqipnia e kohës së tij”, Botimet Françeskane, Shkodër 2008-të.

shoqëria shqiptare ka mbetur e pandjeshme ndaj dëshmimeve të tilla. Ajo ka pasur frikë të përballet me këtë lloj leximi. Kjo ka ndodhur sepse në Shqipëri ka pasur një politikë harrimi të krimëve të komunizmit. Kjo politikë ndahet në tri etapa a) fshehja dhe manipulimi i provave b) relativizimi i krimit dhe shpërndarja e fajit c) harrimi i asaj që ka ndodhur, ka bërë që dëshmitë e burgjeve shqiptare në mos të zhduken, të jenë një kategori e marginalizuar e shkrimeve për diktaturën.”<sup>4</sup> Duke u kthyer te konteksti i zhanrit në Shqipëri, kujtime shkruajnë edhe personazhet kryesorë të nomenklaturës komuniste si Ramiz Alia e Nexhmije Hoxha, si “*Jeta ime*” dhe “*Jeta ime me Enverin*”, ku spikat tendenca e justifikimit historik në raport me gjuhën e aktualitetit. Shkrimtarë si Lasgush Poradeci, Musine Kokalari, Ismail Kadare, Petro Marko, Vedat Kokona, Fatos Kongoli, Helena Kadare me vëllimet “*Vizitat e zonjës Ana X në kullën time*”, “*Mbi jetën time*”, “*Ftesë në studio*”, “*Nga njëri dhjetor në tjetrin*”, “*Pesha e kryqit*”, “*Retë dhe gurët*”, “*Endur në tisin e kohës*”, “*Iluzionët në sirtar*”, “*Kohë e pamjaftueshme*” japin shumë elemente biografike të jetës së tyre të përziera me kujtime, por, mbi të gjitha, në disa raste këta libra shërbejnë si një hartë thesari për të shpjeguar veprën e tyre sipas variantit të autorëve. Ndërsa rrëfime apo kujtime kushtuar një personi të veçantë ose disa personave janë ato të At Zef Pllumit “*Françeskanët e mëdhaj*”, të Petraç Kolecicës “*Lasgushi më ka thënë*”, të Çatin Saraçit “*Zogu i shqiptarëve*”, deri te rrëfimet kujtimore për bashkëshortin të Nexhmije Hoxhës “*Një jetë me Enverin*”, të Mynevër Shuteriqit “*Një jetë me dashuri*” dhe të Sofokli Lazrit “*Rikthimi i dhembjes*” kushtuar Ramize Gjebresë dhe Zaho Kokës.

Në diasporë letërkëmbimi ndërmjet personaliteteve të emigracionit merr gjithashtu një rëndësi të veçantë historike. Prej tyre mund të citojmë disa syresh si letërkëmbimet e De Radës me Dora D’Istrian, të Faik Konicës me Nikolla Naçon, Apolinerin, Shtjefën Gjeçovin etj., ato të Fishtës me At Pal Dodën, të Mithat Frashërit me të dashurën e vet rumune të gjakut princëror apo me personalitete në shumë vende të botës, të Luigj Gurakuqit me klerin katolik të Shkodrës dhe me të tjerë, të Fan Nolit me Lame Kodrën, të Mustafa Krujës me At Paulin Margjokajn, të Ernest Koliqit me Camajn, Namik Resulin e Zef Valentinin, të Camajt me Arshi Pipën dhe, së fundmi, letërkëmbimet e Ismail Kadaresë me personalitete botërore e kombëtare apo ato të At Zef Pllumit me hierarkinë fetare në Vatikan dhe në vend, me personalitete të ndryshme të kulturës dhe të politikës. Një lloj i veçantë epistolari është ai i Egon Gjadrit, “*Letra gruas sime të vdekur*”, ku autori e ka organizuar tekstin e tij mbi gjashtë letra të gjata, të cilat në periudha të ndryshme ia shkruan gruas së tij ndonëse ajo ka vdekur, duke i rrëfyer jetën e përditshme të tijën dhe të djalit të tyre.

<sup>4</sup> Mark Marku, “*Morali i shkrimit*”, gazeta “Panorama”, 17 prill 2009-të.

Gjithashtu, ndër aktet e veçanta letrare e intelektuale me karakter memuaristik është edhe letra që Mitrush Kuteli u lë familjarëve para vdekjes së tij.

Ndërsa për themelues të llojit të ditarit në gjuhën shqipe për sa i përket traditës laike njohim Jeronim De Radën, i cili sipas Arshi Pipës mbajti një "ditar me kod".<sup>5</sup> Gjithashtu, sipas informacioneve që sjell Shaban Sinani, ekzistojnë një numër i madh ditarësh të pabotuar të personaliteteve të ndryshme si ato të Lef Nosit, Mirash Ivanajt, Mithat Frashërit, Ramize Gjbresë, Shtjefën Gjeçovit, Justin Rrotës, Dhimitër Shuteriqit<sup>6</sup> etj., por më i përfoluri prej tyre mbetet ai i At Pal Dodës, që iu mor autorit forcërisht në vitin 1946-të nga forcat e sigurimit. Botimi i këtij ditari filloi në vitin 1993 në revistën "Hylli i Dritës", por pas ndërhyrjeve të hierarkisë kishtare u ndërpre. Kjo panoramë e letërsisë memuaristike të huaj dhe shqiptare na lejon të themi se fillesat e letërsisë memuaristike shqiptare përkojnë me atë të letërsisë europiane në tërësi duke i zhvilluar të gjitha gjinitë e saj, dhe në shekullin e 20-të ajo konsolidohet më shumë nëpërmjet zhanrit të kujtimeve duke shfaqur të gjitha trajtat që ky zhanër merr në letërsinë memuaristike europiane.

Ky kronotop real është - sheshi ("agora"). Në shesh së pari u shpërfaq dhe u formatua vetëdija autobiografike e njeriut dhe e jetës së tij në truallin e antikës klasike. Por autobiografia nuk është vetëm se një vetanalizë, ngase ajo ka nevojë për një formë të veçantë rrëfimore. Në zhvillimin e biografisë si të tillë dallohen qartë disa periudha (jo medoemos me vijimësi njëra pas tjetrës): ato përkojnë me epokat e tronditjeve të mëdha dhe të kthesave. Në rrethana të tilla, personalitete të veçanta përjetojnë një nevojë të mprehtë për vetëshprehje - dhe krijojnë vepra të shënuara, ndër të cilat janë mbresëlënëse zhanret e autobiografive. Periudha e lulëzimit të zhanrit autobiografik ka qenë e lidhur me shekullin e Iluminizmit. Autor tipik i kësaj periudhe është Zhan Zhak Ruso. Në "*Rrëfimet*" dhe në vepra të tjera autobiografike ("Shëtitjet e një ëndërrimtari të vetmuar", 1802) ai e përshkruan veten pa asnjë zbulim dhe lëshohet në rrëfime të singerta, që mund të shkojnë deri në ekzibicionizëm. Krijues më të njohur të veprave autobiografike të kësaj periudhe dhe të shekujve të mëvonshëm kanë qenë B. Franklini, K. Goldoni, Xh. Kazanova, E. Gibbon-i, I. V. Gëte, Shatobriani, V. Skoti, Stendali, T. De Kuinsi, A. Lamartini, Zh. Sandi, XH. Stjuart Milli, Ç. Darvini, A. Hercen, L. Tolstoi dhe F. Niçe.

Me fillimin e shekullit XX zhanri i autobiografisë hyn në periudhën e saj të katërt të transformimit. Zbulimet e reja në sferën e psikologjisë sugjeruan meditime më të posaçme mbi vështirësitë e personalitetit njerëzor, ndër të tjera edhe mbi mekanizmat e pavetëdijshëm të veprimtarisë psikike. Shfaqen në

<sup>5</sup> Citim sipas Shaban Sinanit, op. cit.

<sup>6</sup> Ibidem.

këtë kohë ideologjitë konkurruese, rivaliteti i tyre derdhet tashmë jo në "luftën" e ideve, por në luftë në kuptimin tekstual të fjalës - dhe në përmasa që i tejkalojnë të gjitha konfliktet e së shkuarës.

Nuk është për t'u habitur që në shekullin XX u shkruan më shumë autobiografi sesa në të gjitha epokat e mëparshme të marra së bashku. Ndërkaq do të kishte qenë e vështirë të veçonim ndonjërin prej tyre si përfaqësuese tipike në akord me epokën. Në radhën e biografëve më të shquar të shekullit XX mund të përmendim Henri Adamsin, Çestertonin, Teodor Drajzerin, A. Zhidin, M. Gorkin, H. Xhejmsin, M. Tuenin, H. Xh. Uellsin, U. B. Jitsin dhe Zh. P. Sartrin.

Nëse e kundrojmë zhanrin e autobiografisë më shumë nga pikëpamja letrare, sesa nga pikëpamja historike, atëherë në të mund të dallojmë një sërë përbërësish. Së pari, autobiografitë dallohen për nga korrelacioni i ngjarjeve fizike dhe "mentale" nisur nga fakti se sa vend u kushtohet nga njëra anë akteve, vëzhgimeve të sferës përreth autorit, dhe nga ana tjetër duke u nisur nga puna e tendosur e shkrimit autobiografik mbi përjetimet dhe përsiatjet. Së dyti, autobiografitë dallohen për nga gjerësia e problemeve të prekura, që nga ana e tyre, varen nga mundësitë e përvojës jetësore të autorit, nga karakteri, botëkuptimi dhe formimi i autorëve të tyre. Së treti, kemi edhe dallimet e cilësive morale, pjesërisht të kushtëzuara nga disa faktorë shtesë: "vitaliteti aktiv" dhe besueshmëria e kujtesës së biografit, ndershmëria dhe objektiviteti i tij, singleriteti me të cilin ai flet për veten dhe nga vlerësimet e tij të ndryshme. Së fundmi, autobiografitë dallohen për nga virtytet e tyre artistike për mënyrën se si një autor zgjedh më të rëndësishmen, organizon materialin, vlerëson ndërsjelltësinë e shkaqeve dhe, si rrjedhim, për mënyrën se si shpërfaq një plan të vetëm kundrejt shumëllojshmërisë së dukurive jetësore.

Qëllimi i autobiografisë është të paraqesë jetën (apo ndonjë pjesë të saj) si diçka të plotë, kur ngjarjet e përshkruara ndahen me të tashmen me një distancë kohore dhe kur autori u qaset këtyre ngjarjeve pak a shumë pa pasione, ndërsa vetë ngjarjet kanë arritur të përftojnë në sytë e tij një kuptimësi të madhe apo të paktë<sup>7</sup>. Rrjedhimisht, autobiografia dallohet nga ditari, që fikson ditë pas dite faktet dhe mbresat. Autobiografia dallohet gjithashtu edhe nga kujtimet (memuaret), edhe pse këto dy lloje të shkrimit shpesh i ngatërrojnë, për shkak se paraqesin historinë personale të autorit, ndërkaq që memuaret paraqesin historinë e ngjarjes, që prek në njëfarë mënyrë të gjithë shoqërinë. Megjithëse zhanrin e autobiografisë e quajnë një zhanër proze, të paktën një prej modeleve që e kundërshton këtë është forma poetike e poemës së Urdsuorthit "*Prelude*", e shkruar më 1805-ën. Në përgjithësi, motivet

---

<sup>7</sup> *Dictionnaire de Michel de Montaigne*. Dirigé par Ph. Desan. — P.34.: Champion. — 2004

autobiografike (haptazi ose të maskuara) ndeshen në poezi jo aq rrallë: mjafton të kujtojmë "*Satirat*" dhe "*Epistulat*" e Horacit, "*Jeta e re*" të Dantes, "*Udhëtimi i Çajld Haroldit*" të Bajronit, si dhe "*In Memoriam*" të Tenisonit etj. Po ato motive autobiografike i gjejmë shpesh të pranishme edhe në eseistikë - te Ç. Lemi, U. Hezlit, R. L. Stivensoni dhe tek autorë të tjerë.

Për më tepër, madje edhe letra private - në thelb, është një "anekdotë" autobiografike tok me komentaret ndaj saj (njëmend, po aq fragmentare, ashtu si shënimet e ditarit). Tregues të kësaj marrëdhënie me letrën janë trashëgimia epistolare e H. Uollpolit dhe e Virxhinia Ulfit.

Nganjëherë, në formën e autobiografisë janë përshtatur histori të sajuara, si ajo e romanit "*Robinson Kruzo*" të Defosë, "*Udhëtimet e Guliverit*" të Suiftit, "*Rob Roi*" i Skotit, "*Historia e Henri Esmondit*" e Thekërit dhe shumë libra të tjerë. Por po aq shpesh ka ndodhur e kundërta: romancierët i kanë shtrënguar heronjtë e tyre të kalojnë përmes sprovave që kanë kaluar vetë autorët në përvojën e tyre private jetësore. Shembujt më të njohur të këtij lloji janë romanet "*Amelia*" të Fildingut, "*David Koperfildi*" të Dikensit, "*Adolfi*" të B. Konstan, "*Ajo dhe ai*" dhe romane të tjera të Zhorzh Sandit, "*Xhejn Ejr*" të Sahrrotë Bronte-së, të gjitha romanet e Tolstoit, "*Në kërkim të kohës së humbur*" të M. Prustit, "*Bijtë dhe dashnorët*" të D. H. Lourensit dhe "*Barra e rëndë e pasioneve njerëzore*" të S. Moem-it.

Autobiografia shkruhet shpesh për shkaqe speciale – p.sh.: një shkrimtar që ka përshkuar rrugën e pjekurisë në formimin e tij (rastet e H. L. Borhesit, G. G. Markezit etj., por edhe At Zef Pllumit me "Sagën e fëmijërisë" bën të mundur që ngjarjet të prekin kryesisht vetëm jetën në fëmijërinë e autorit dhe tangencialisht segmente që kanë të bëjnë me jetën shoqërore). Autobiografia i kushtohet veçanërisht ndonjë ngjarjeje që ka shënuar kthesë në jetën e shkrimtarit dhe shpesh quhet *rrëfim*. Tek Pllumi, ngjarja që rrëfëhet të "Saga" është misioni që ngjizet në fëmijëri bashkë me dëshirën për t'u bërë frat dhe "*për të marrë diellin e për ta vu në ball si sy me të cilin me shndritë gjithë botën*".<sup>8</sup> Së fundmi, nëse kujtimet për një person të afërm janë shkruar në lidhje me vdekjen e tij dhe nën mbresat e drejtpërdrejta në lidhje me këtë gjë, atëherë kemi formën e nekrologjisë dhe të nekrologut.

Duhet të pranojmë se kjo skemë klasifikimi është e reduktuar dhe nuk pretendon të shterojë thelbin zhanror të çdo vepre të letërsisë memuaristike, ndonëse na përfron me hapjen e këtij thelbi. Hulumtimi i formave të letërsisë memuaristike duhet të jetë konkret: vetëm atëherë analiza tipologjike nginjet me përmbajtjen konkrete klasore dhe na jep një përfytyrim më të qartë mbi thelbin e atyre tendencave shoqërore-politike, të cilat mandej, përcaktojnë në vetvete zhanret e veçanta të letërsisë memuaristike.

<sup>8</sup> At Zef Pllumi, "*Saga e fëmijërisë*", Botimet Françeskane, Shkodër 2009, f. 3.

“Në ikonologjinë e rilindjes, kujtesa ishte përfaqësuar nga një grua me dy fytyra: një fytyrë nga e shkuara, tjetra drejt së tashmes; në njërën dorë ajo mban një libër (nga i cili mund të lexojë mbi të shkuarën), në tjetrën dorë një pendë (për të shkruar libra të rinj). Kështu, puna e kujtesës i nënshtrohet dy ekzgjencave: besnikërisë ndaj së shkuarës dhe dobishmërisë për të tashmen.”<sup>9</sup>

Teksa lexojmë opusin e veprës së At Zef Pllumit, bindemi dora-dorës se jeta e tij është pikërisht ai libri i ikonologjisë, vetë kujtesa! Fëmijëria, rruga për t’u bërë frat, të qenët nxënës i Fishtës, Prenushit, Harapit, bisedat dhe identifikimi me ta, netët e gjata në një arkiv, dokumentet e të cilit datojnë në vitin 1415-të, shkëputja e dhunshme, ndërrimi i hipostazave, dhuna dhe burgjet e gjata, janë kapitujt e këtij libri vetë e shkuara! “*Rrno vetëm për me tregue*”, “*Françeskanët e mëdhaj*”, “*Frati i pashallarëve bushatli*”, “*Ut heri Dicebamus*”, “*Saga e fëmijnisë*”, “*Histori kurrë e shkrueme*” apo “*Njerëz fisnikë*” janë transferimi i kujtesës në libra si dobishmëri, për të cilën kemi folur gjatë diku tjetër. Të gjitha keto tekste së bashku formojnë atë që prej 15 vjetësh e quajmë letërsia memuaristike e At Zef Pllumit. Por “*Rrno vetëm për me tregue*” është vepra më përfaqësuese e tij dhe një nga veprat më të rëndësishme të kulturës shqipe të shekullit XX.

Kjo vepër është dëshmia më rrëqethëse e burgjeve komuniste. Aty gjen të fiksuar detaj pas detaj jo tragjedinë e jetës së një personi, por tragjedinë e jetës së një populli, aty njeh më mirë se në të gjitha kryeveprat e letërsisë botërore egërsinë dhe barbarinë njerëzore, mjerimin dhe trishtimin e njeriut, mënyrën se si përballen mes tyre diktaturat dhe individët, se si tjetërsohen, poshtërohen dhe se si qëndrojnë njerëzit. Po kështu, ky libër “*është model i tekstit në veprim. I atij teksti i cili, me një mijë e një fije të padukshme, ndërlihet aktivisht me problematiken pa fund të shoqërisë e të jetës shqiptare, me historinë, kulturën, etnosin, identitetin, çështjet aktuale dhe me prefigurimin e së ardhmes. Një intertekst dinamik, që na fton të jemi aktorë të tij dhe që beson pafundësisht në vullnetin e mirë të grigjës shqiptare. Një libër i hapur mbi botën tonë të koklavitur, që lexuesit i flet me dashurinë karakteristike të bariut të shpirtrave, kurse studiuesit i dërgon sinjale të çmueshme dokumentimi dhe kode arshivash të zhdukura. Është një libër priftëror, mbi të gjitha: i shkruar nga dashuria dhe për dashurinë. I rrallë, për kohën tonë prozaikë. Dhe shumë i vyer. E i rëndë*”<sup>10</sup>. Ky libër është i veçantë

<sup>9</sup> Tzvetan Todorov, “*Memoria Del Male, Tentazione Del Bene*”, Garzanti, Milano 2009, f. 238. “Nell’iconologia del rinascimento, la memoria era rappresentata come una donna dai due volti, uno volto verso il passato, l’altro verso il presente; in una manotieneun libro (in cui puo attingere le proprie informazioni), nell’altra una penna (probabilmente per poter scrivere nuovi libri). Il lavoro di memoria si sottopone a due serie di esigenze: fedelta verso il passato, utilita per il presente”.

<sup>10</sup> Ardian Marashi, “*Dekalog përshpirtjesh për At Zef Pllumin*”, op. cit.

edhe për faktin që shkruesin e tij e vë në një situatë të veçantë e të pazakontë për autorë të tjerë të shqipes, “*situatë e cila kalon nëpër tri shkallë. Shkalla e parë është jetesa dhe mbijetesa e ferrit (rrno vetëm për me tregue). Shkalla e dytë është përjetimi dhe rijetimi (si kujtesë). Shkalla e tretë është zija e shkrimit që mbështetet në mbijetesë e në rikujtim, për të dhënë dëshminë në trajtën e besueshme bashkë me efektin e reales. Këto faza (situata) kanë peshën shkatërrimtare të subjektit shkrues që duhet të matet me vetveten në çdo fjalë e në çdo frazë. Këtu nuk kemi të bëjmë me lojën e kuptimeve, por me lojën e shpirtit, për të sprovuar edhe një herë qëndresën*”.<sup>11</sup> Letërsia memuaristike shqiptare dallohet qartë për nga synimi themelor: riprodhimi i saktë i një pjese të realitetit. Në dallim nga letërsia artistike, veprat e letërsisë memuaristike bartin në vetvete funksione kryekëput apo kryesisht njohëse, pa ndonjë pretendim për novacion special artistik. Megjithatë, shpesh është e vështirë të dallosh ndonjë kufi të qartë ndërmjet kujtimeve dhe letërsisë artistike. Shpeshherë, zhanret e shumëllojshme të letërsisë memuaristike ndërthuren midis tyre. Si parësore dhe në njëfarë kuptimi - si më e njohura ndër to në letërsinë memuaristike është forma e shënimeve të ditarit – shënimet e përditshme apo periodike, të cilat parashtrajnë ngjarje nga jeta personale nën sfondin e ngjarjeve bashkëkohore të shkrimtarit.

Ditari paraqet në vetvete formën parësore të letërsisë memuaristike – perspektiva e përgjithshme në këto shënime, si rregull, mungon, dhe rrëfimi përmbahet skrupulozisht në lidhjen molekulare të shënimeve, që përbashkon në një tërësi personat e përshkruar me sistemin e botëkuptimit të autorit.

Në kujtime ka më pak rastësi; në to janë shumë më tepër të pranishme elementet përzgjedhëse dhe pikëprerjet e ngjarjeve. *Kujtimet* e autorëve shqiptarë janë lloji i dytë i letërsisë memuaristike. Si lloj të tretë të kësaj letërsie mund të quajmë *autobiografinë*, që është më e shkurtër se *kujtimet* për nga vëllimi dhe që përfshin momentet më të rëndësishme e ngërthyesë, të cilat shënojnë momente kthese në historinë e personalitetit të rrëfyesit (kujtimet mund të rrëfejnë për realitetin në përgjithësi, ndërsa për *autobiografinë* është qendror roli i personalitetit në rrëfim ku narratori e protagonist i përkojnë me njëri-tjetrin).

Autobiografia është një formë e shkrimit biografik ku heroi kryesor është vetë autori; zakonisht, autobiografia shkruhet në vetë të parë dhe ngërthen një pjesë të madhe (ose pjesën më të madhe) të jetës së tij.

Synimi autobiografik, nëse e kundrojmë atë në perspektivën historike, është më shumë karakteristikë e kohës së re, sesa e epokës antike. Sipas gjasave, burimet e vetanalizës ia vlen t'i kërkojmë, madje jo aq sa në letërsinë

<sup>11</sup> Sabri Hamiti, “*Albanizma*”, f. 180.

antike, sesa në psalmet e Testamentit të Vjetër, në librat e profetëve dhe në dërgesat e Testamentit të Ri.

Këto forma klasike të autobiografisë dhe të biografisë nuk kanë qenë vepra të letërsisë së karakterit konkret libresk, të shkëputura nga ngjarjet konkrete shoqëro-politike me publikimin sensacional të tyre. Përkundrazi, ato në njëfarë mënyre përcaktoheshin nga këto ngjarje, ishin akte qytetaro-politike të përlëvdimit publik apo të hyznizimit publik të njerëzve realë. Prandaj, këtu është me rëndësi jo vetëm dhe jo aq kronotopi i brendshëm i tyre (domethënë, kohë-hapësira e jetës së paraqitur), por para së gjithash - ai kronotop real, në të cilin kryhet kjo paraqitje e jetës personale apo të huaj si një akt qytetaro-politik i përlëvdimit publik. Pikërisht në kushtet e këtij kronotopi real, në të cilin shpërfaqet (publikohet) jeta personale apo e huaj, përkufizohen kufijtë e imazhit të njeriut dhe të jetës së tij dhe hidhet një dritë e caktuar mbi të në këtë kontekst zhanri shqiptar i memuareve, epistolave dhe biografive i përmbush pritshmëritë dhe është mjaft i sintonizuar me zhvillimet e zhanrit në letërsinë europiane qoftë në kohë dhe në tendencë. “Rrno vetem per me tregue” i At Zef Pllumit në veçanti.

### SUMMARY

This article makes a chronological overview of the genre of memoir, epistle and biography in the Albanian literature since its origin, and here it deals with the Latin writing of Barleti and Gjon Muzaka, to proceed with an evidence of the elements of this genre in the “Missal” of Buzuku or Budi and Bogdani which accomplish these ideas through epistle, correspondence style as well as their comments.

Through the inductive method, together with historical coverage of all stages and development of this genre in all its manifestations, including those through the testimony *classic memories* and explanations on the first personal pronouns, with *epistle* proving the connection of the author with the time, with the world of letters, with individuals and institutions, intermediate cases *between epistle and necrology*, the *memories* and the shocking evidence, which may serve as a source for the story in dark phases, *correspondence*, *diary* and *autobiography*, the article aims to prove that the Albanian genre of memoir, epistle and biographies fulfills the expectations and is quite fine-tuned developments on the genre of European literature on time and on trend.

According to this Which makes the introduction of foreign personal life as an act of civic-political and foreign publicized personal life, defined the boundaries of the image of man and his life, “Live only to tell” of Father Zef Pllumi occupies a 15-year literature representative of the author, but also in the twentieth century of the Albanian culture.

